



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Nr. 436 prot.

Tiranë, më 05.03 /2026

VENDIM

Nr. 23, datë 05.03. 2026

Për mbështetje të aplikimit të projekteve kërkimore të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në kuadër të Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH) 2026 të AKKSHI-së

Në mbështetje të nenit 4 (pikat 2 dhe 9) të Ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; në pajtim me nenet 4 dhe 57 të Statutit të Akademisë së Shkencave, të ndryshuar; mbështetur në thirrjen për projekt-propozime në kuadër të Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH) për vitin 2026; në Udhëzimin nr. 1, datë 18.02.2026, nr. 312 prot., të miratuar nga Kryesia e Akademisë së Shkencave “Për procedurën e programimit, miratimit dhe ndjekjes së ecurisë së projekteve nga strukturat kërkimore-shkencore dhe administrative të ASHSH-së deri në realizimin e tyre”; si dhe në paraqitjen e tyre në mbledhjen e Asamblesë së ASHSH-së, datë 27.02.2026, dhe duke marrë në konsideratë edhe relacionin e QPKKSH, i cili vlerëson se dosjet e projekteve të sipërpërmendura janë të plota sipas kërkesave të AKKSHI-së, Kryesia e Akademisë së Shkencave, pasi shqyrtoi kërkesat për aplikim të paraqitura nga njësitë kërkimore-shkencore të ASHSH-së dhe të miratuara nga strukturat përkatëse, në mbledhjen e saj të datës _____.____.2026,

Vendosi:

1. Të miratojë mbështetjen e aplikimit pranë AKKSHI-së të projekteve:

- a) *Artizani: Hartëzimi Kombëtar i Dijebërjes Artizanale (AHKDA), në fushën e shkencave sociale dhe albanologjike*, me drejtues Dr. Silvana Nini. Grupi i punës përbëhet nga Silvana Nini, Ermela Broci, Edlira Caushi, Elvis Gorica dhe Arben Ilollari. Institucioni bashkëpunues është Universiteti i Tiranës, ndërsa mbështetja institucionale është dhënë nga Instituti i Antropologjisë, i miratuar në Departamentin e Etnologjisë dhe Folklorit. Projekti ka një kohëzgjatje prej 24

muajsh, me një buxhet të kërkuar nga AKKSHI prej 4,583,690 lekë dhe pa financim nga ASHSH; buxheti total i projektit është 4,583,690 lekë.

- b) *Risku sizmik i ndërtesave tip të sistemit arsimor dhe riaftësimi i tyre i integruar – mbështetur në gjetjet pas tërmetit të 26 nëntorit 2019, në fushën Biodiversiteti dhe mjedisi, me drejtues Prof. asoc. Markel Baballëku. Grupi i punës përfshin Markel Baballëku, Rrapo Ormeni, Gjergji Islami, Altin Bidaj, Rikard Luka, Renti Haziraj dhe Mimoza Monka. Institucionet bashkëpunuese janë Fakulteti i Ndërtimit, UPT dhe Fakulteti i Arkitekturës, UPT. Projekti është mbështetur nga Njësia e Gjeoshkencave dhe Gjeoinxhinierive, me përfshirje edhe të vlerësuesve të jashtëm. Kohëzgjatja e projektit është 30 muaj, me një buxhet të kërkuar nga AKKSHI prej 4,385,444 lekë dhe një kontribut nga ASHSH prej 60,000 lekë; buxheti total i projektit është 4,445,444 lekë.*
- c) *Ndërtimi i një Strategjie/Plani Kombëtar për Mbrojtjen nga Radoni në Shqipëri, në fushën biodiversiteti dhe mjedisi, me drejtues Dr. Gjon Rrota. Në grupin e punës marrin pjesë Gjon Rrota, Anita Berberi, Adisa Daberdini, Dhori Dapi, Dionald Mucaj, Olgert Gjuzi, Gazmend Nafezi dhe Aida Ferra. Institucionet bashkëpunuese janë Universiteti Politeknik i Tiranës, Instituti i Gjeoshkencave dhe Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Kosovë. Projekti është mbështetur nga Njësia e Gjeoshkencave dhe Gjeoinxhinierive, me vlerësues të jashtëm. Kohëzgjatja e projektit është 30 muaj, me një buxhet të kërkuar nga AKKSHI prej 3,599,558 lekë dhe një kontribut nga ASHSH prej 54,720 lekë; buxheti total i projektit është 3,654,278 lekë.*
- d) *Cilësia mjedisore e ujërave termale shqiptare dhe siguria për përdorim balneologjik: karakterizim kimik, vlerësim i riskut shëndetësor dhe zhvillim metodash monitorimi, në fushën biodiversiteti dhe mjedisi, me drejtues Akad. Besnik Baraj. Grupi i punës përbëhet nga Besnik Baraj, Majlinda Vasjari, Alma Shehu, Petrit Vargu, Kledi Xhaxhiu, Ana Ameda, Lueda Kulla, Evald Hymet dhe Enkelejda Misha. Institucionet bashkëpunuese janë Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Universiteti i Mjekësisë. Projekti është mbështetur nga Njësia Pasuritë ujore, pa vlerësues të jashtëm. Kohëzgjatja është 30 muaj, me një buxhet të kërkuar nga AKKSHI prej 4,995,046 lekë dhe pa financim nga ASHSH; buxheti total i projektit është 4,995,046 lekë.*
- e) *“Përcaktimi i aftësive mbajtëse të ngarkesës turistike në peizazhet natyrore e sociale, përmes sigurimit dhe përpunimit të informacionit me teknologji të avancuara GIS dhe Drone dhe digjitalizimit me metoda të reja: Model*

ndërdisciplinor Ksamil–Butrint”, në fushën “Shkencat sociale dhe albanologjike”, me drejtues Prof. Perikli Qiriaz. Projekti paraqitet nga Njësia e Përkohshme e Kërkimeve Gjeografike, në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Tiranës dhe Universitetin “A. Moisiu” të Durrësit. Projekti ka një kohëzgjatje prej 24 muajsh, me një buxhet total prej 4,672,825 lekë, nga të cilat 4,507,825 lekë kërkohen për financim nga AKKSHI, ndërsa pjesa tjetër përfaqëson kontribut institucional.

- f) *ParlaMint Shqipëri: Një korpus kombëtar i debateve parlamentare*, në fushën “Shkencat sociale dhe albanologjike” me drejtues dr. Edmond Cane. Projekti paraqitet nga Qendra e Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike, në bashkëpunim me Universitetin “Luarasi” dhe Kuvendin e Shqipërisë. Projekti ka një kohëzgjatje prej 24 muajsh, me një buxhet total prej 3,381,820 lekë, nga të cilat 2,521,820 lekë kërkohen për financim nga AKKSHI, ndërsa pjesa tjetër përfaqëson kontribut institucional.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: kancelari, drejtori i QPKKSH, sektori i financës dhe i buxhetit, si dhe kryetarët e seksioneve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder Gjinushi
KRYETAR

